

Shqipëri
Java e
Shoqërisë
Civile
2023

#AFËTËSIPËRTËGJITHË
PËR TË MËSUAR, PUNUAR, ANGAZHUAR



ÇFARË ËSHTË JAVA E SHOQËRISË CIVILE

Java e Shoqërisë Civile (JSHC) është një aktivitet kombëtar tematik i përvitshëm, që përfshin një seri eventesh dhe hapësire promovimi dedikuar punës dhe veprimtarisë së organizatave dhe aktivistëve të shoqërisë civile në vend.

Java krijon mundësi për të gjithë aktorët e shoqërisë civile, për t'u bërë bashkë, si katalizatorë të ndryshimeve pozitive në shoqëri, për të diskutuar dhe krijuar zgjidhje dhe veprime të përbashkëta në të ardhmen.

Java e Shoqërisë Civile 2023 [#JSHC2023](#) do të zhvillohet përgjatë periudhës **29 maj-3 qershor 2023**.

Çdo vit, përzgjidhet një tematikë në linjë me aktivitete ndërkombëtare si dhe zhvillime të rëndësishme në vend apo në sektorin e shoqërisë civile.

Tematika në fokus do të jetë **"Aftësi për të gjithë: Për të mësuar, punuar, angazhuar"** në vijim edhe të shpalljes të vitit 2023 si "Viti Evropian i Aftësive", nga Komisioni Evropian.

Java organizohet nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, dhe zbatohet në partneritet me organizata, aktivistë dhe grupe formale dhe informale të shoqërisë civile.

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri është një nismë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA), me mbështetjen e Bashkimit Evropian

AKTIVITETET E JAVËS SË SHOQËRISË CIVILE

Java përfshin një seri aktivitetimesh lokale organizuar nga aktorë të shoqërisë civile në mbarë vendin, si dhe një event kombëtar i cili mbledh bashkë të gjithë grupet e interesit si organizata të shoqërisë civile, aktivistë, donatorë, institucione qeverisëse në nivel vendor dhe qendror, institucione akademike, biznese, media etj. në panele diskutimi dedikuar temës në fokus të javës.



AKTIVITETET LOKALE TË JAVËS SË SHOQËRISË CIVILE NË PARTNERITET ME OSHC-TË

Aktivitetet lokale të javës përfshijnë çdo aktivitet të organizuar përgjatë periudhës **29 maj-3 qershor 2023** nga OSHC-të në bashkëpunim me aktorë e grupe interesi, e që kontribuojnë në diskutimin publik të temës në fokus.

Natyra e aktiviteteve lokale është e larmishme dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë forume diskutimi, seminare, sesione informimi dhe ndërgjegjësimi, evente rrjetëzimi dhe shkëmbimi praktikash të mira, vizita apo ture, ditë të hapura, programe trajnimi, festivale dhe panairë apo aktivitete të tjera advokuese etj. Aktivitetet mund të organizohen individualisht ose në partneritet.

TEMATIKA E AKTIVITETEVE PËR #JSHC2023

Këtë vit #JSHC2023 synon krijimin e një hapësire informimi dhe diskutimi, promovimin dhe ndarjen e praktikave, zhvillimin e dialogut dhe sinergjisë ndërsektoriale/ndërinstitucionale, mbi zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive për të gjithë, si një mjet për t'u përshtatur dhe qenë i suksesshëm kundrejt kërkesave gjithnjë e në ndryshim të tregut të punës dhe angazhimit gjithëpërfshirës në shoqëri dhe demokraci.

Disa shembuj të tematikave dhe çështjeve për tu adresuar përmes aktiviteteve të Javës paraqiten si më poshtë:

- Aftësitë për jetën
- Të mësuarit gjatë gjithë jetës
- Demokracia pjesëmarrëse: fuqizimi i aftësive të qytetarëve dhe grupeve të interesit për më shumë angazhim në politikëbërje
- Zhvillimi i aftësive për shoqëri më gjithëpërfshirëse me fokus edukimin dhe pjesëmarrjen për kohezion dhe integrim social
- Trajnimi dhe aftësimi profesional
- Aftësitë e të rinjve dhe nevojat e tregut të punës
- Zhvillimi i aftësive për ekonomi më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse/ punësimi dhe vet-punësimi
- Zhvillimi i aftësive për të gjithë; mbështetja përmes mënyrave/mjeteve fleksibël, gjatë gjithë jetës, të përshtatshme për grupe të ndryshme shoqërore (veçanërisht grupet e marginalizuara dhe ato në nevojë)
- Ndryshimet demografike dhe përshtatja e tregut për grupmoshat aktive
- Mospërputhshmëria e aftësive me kërkesat e tregut të punës (anafabeltizëm digjital, NEET etj)
- Aftësitë digjitale dhe të gjelbërta/Përditësimi, ndryshimi i aftësive në shfrytëzim të potencialit të plotë të individit përmes tranzicionit digjital dhe ekologjik
- Aftësimi për transferimin e njohurive dhe forcimin e lidhjes mes aktorëve të shoqërisë (akademi-institucione qeverisëse-shoqëri civile-biznes-media)
- Situata post pandemike; aftësitë adaptuese, ndryshimi i mënyrës së te punuarit
- Edukimi & aftësimi për median dhe informacionin
- Etj.

PËRSE TË BËHENI PJESË E JAVËS

Java e Shoqërisë Civile është një mënyrë e mirë për të treguar se si shoqëria civile dhe aktorë të tjerë të interesuar kontribuojnë dhe luajnë një rol aktiv në ngritjen dhe adresimin e çështjeve me rëndësi për ndryshime pozitive në shoqëri, duke bashkuar forcat për zgjidhje dhe veprime të përbashkëta në të ardhmen, me impakt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës.

Gjithashtu ajo është një mundësi shumë e mirë për zhvillimin e partneriteteve dhe rrjetëzimit, për promovimin e punës së organizatave të shoqërisë civile, rrjeteve të OJF-ve dhe aktorëve të tjerë në fushën e edukimit dhe aftësisimit.

SI MUND TË BËHESH PJESË

Organizatave të shoqërisë civile mund t' i bashkohen JSHC nëpërmjet:

- Aktiviteteve të organizuara në kuadër të projekteve/programeve të tyre në zbatim
- Aktiviteteve të dizenuara posaçërisht për JSHC me mbështetjen financiare të NRC. Mbështetja financiare do të ofrohet vetëm për një numër të kufizuar aktiviteteve (10-15 aktivitete) dhe konsiston në mbulimin e shpenzimeve logjistike të eventit. Përparësi do tu jepet organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të OSHC-ve me aktivitet jashtë Tiranë dhe aktiviteteve të propozuara dhe zbatuara në partneritet dhe me përfshirjen e sa më shumë aktorëve si institucione ligjzbatuese, akademisë, medias etj.



Të interesuarit, mund të shprehin interesin e tyre duke plotësuar **Formularin e Aplikimit**.

Formulari duhet të dorëzohet i firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi i organizatës dhe të dërgohet në adresën info@resourcecentre.al brenda datës **2 maj 2023!**


Organizatave të përzgjedhura do të kontaktohen brenda datës 5 maj 2023!

KUSH MUND TË BËHET PARTNER NË ORGANIZIM

Të gjitha organizatat e shoqërisë civile, rrjetet e organizatave, aktivistët apo grupimet informale, të cilët punojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin dhe adresimin e çështjeve të mësipërme mund të shprehin interesin e tyre për t`ju bashkuar JSHC si organizatë partnere.

SI PJESË E JSHC

- Të gjitha aktivitetet e organizatave partnere në Javën e SHOQËRISË CIVILE, nën logon e dedikuar të Javës, do të listohen, publikohen dhe promovohen në të gjitha rrjetet e komunikimit të Qendrës Kombëtare Burimore, si pjesë e Kalendarit të Eventeve të JSHC.
- Materiale promovuese të personalizuar për çdo aktivitet lokal, në formën e posterave dhe videove online, do të zhvillohen nga Qendra dhe ndahen në të gjitha mediat e saj sociale, duke përfshirë informacion të shkurtër mbi organizatën, punën e saj si dhe qëllimin dhe impaktin e aktivitetit.
- Gjatë javës do të ketë promovim mediatik të aktiviteteve të JSHC, si dhe të punës e impaktit të sektorit në mbarë vendin në drejtim të tematikës së Javës.
- Aktorët e shoqërisë civile partnerë të Javës do të listohen si pjesë e Dokumentit Përmbledhës së JSHC, i cili ndahet gjerësisht me organizata të shoqërisë civile dhe donatorë në vend e rajon, institucione në nivel qendror dhe vendor, institucione akademike, media, biznese etj.



KUSHTET PËR BASHKËPUNIM

Një marrëveshje bashkëpunimi do të nënshkruhet midis Parterëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe organizatës partnere. Aplikantët duhet të kenë parasysh objektivin kryesor të Javës së Shoqërisë Civile: java ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin për tematikën në fokus, të lehtësojë diskutime rreth saj dhe të rrisë interesin publik dhe institucional, si dhe të promovojë rolin dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile në zhvillimin e aftësive.

Aktivitetet nuk duhet të përdoren për interesa komerciale, politike ose të ndonjë natyre tjetër që mund të dëmtojë vizionin dhe objektivin e ngjarjes.



Java e Shqipëri Shoqërisë Civile 2023

Për çdo pyetje rreth JSHC na shkruani në info@resourcecentre.al

Gjeni këtu një përmbledhje të aktiviteteve të [Javës së Shoqërisë Civile 2022](#).